



Dhjetor / Dezember 2020

shqip

O grua, e madhe është feja jote!

(Mt 15,25)

Kontakt:

Meinolf Wacker
Kirchplatz 7
59174 Kamen

Mobil.:

+49-172-5638432

Mail:

meinolf.wacker@go4peace.eu

Homepage

www.go4peace.eu

Mos u dorëzo!

Don't give up!

Të dashur miq të fjalës!

Shumë shpesh, kishte pasur eksperiencë të vështira tek zyrat e punëve të jashtme. Kjo studente, e cila vinte nga një vend shumë i varfër, kishte pasur vështirësi tek bënte lejen e qëndrimit. Shpesh, kur i kishte munguar ndonjë dokument ose informacion ajo ishte refuzuar me ftohtësi pa marrë shpjegime të tjera. Për të ishte si një udhë kryqi që çdo vit të rinovonte vizën për një vit të ri. Edhe këtë herë i mungonte diçka. Ajo u refuzua me një shikim të ftohtë për shkak të vendit nga i cili vinte. Ajo u largua duke qarë. Mirëpo, ajo nuk kishte kuptuar me të vërtetë se çfarë i mungonte. Motoja e jetës së saj i erdhi në mendje: “Mos u dorëzo! Don't give up!” Kështu, ajo mori guximin edhe një herë dhe u fut brenda. Këtë herë, punonjësja e zyrës u tregua më e dashur, dhe rezultoi që studentja i kishte të gjitha dokumentet e nevojshme.

Ngjashëm e kishte përjetuar edhe një nënë nga Kanania, vajza e të cilës ishte shumë e sëmurë. Ajo kishte nevojë për ndihmë. Kjo grua kishte dëgjuar për Jezusin. Ajo shkoi tek ai dhe bëri thirrje për ndihmë. Jezusi reagoi shumë ftohtë, pasi në fillim kishte vëmendjen vetëm tek hebrenjtë. Ai i tha gruas: “Nuk është e drejtë tua marrësh bukën fëmijëve dhe tua hedhësh qenve!” Por, ajo grua pagane në sytë e Jezusit nuk dorëzohet. Ajo i përgjigjet atij: “Ke të drejtë zotëri, por edhe vetë qentë hanë nga dromcat që bien nga tryeza e zotërisë së tyre.” (Mt 15,27) Ky besim, që nuk dorëzohet, e preku shumë Jezusin, kështu ai tha: “Grua, e madhe është feja jote! Çfarë ti dëshiron do të plotësohet!” Dhe kështu vajza iu shërua.

Jeta duhet shpesh të luftohet. Shumë gjëra nuk na bien aq lehtë mbi tryezë. Shumë gjëra kërkojnë prej nesh durim dhe këmbëngulje. Ai që nuk dorëzohet në vështirësi, tregon një forcë shpirtërore, që prek zemrat dhe vë diçka në lëvizje. Ata që këmbëngulin, i japin paqes një shans të vërtetë - në zemrën e tyre dhe në ndërveprimin e përditshëm me njëri-tjetrin. **Mos u dorëzo! – Don't give up!**

për OnWordTeam

Meinolf Wacker